



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0238**

**OSHP: 2025/0237**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE “SEMAKS” SH.P.K., si dhe OE “Pro & Co Group” SH.P.K., kundër Njofitmit të kontratës ose me dokumentet e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi I projektit të integruar të Bulevardit të qytetit Gjilan” me numër të prokurimit 651-25-644-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL- GJILAN”, më 22/05/2025, mori këtë:

### **Vendim**

1. Aprovohen, si pjesërisht të bazuara ankesat e OE “SEMAKS” SH.P.K., me nr. 2025/0237, e datës 04/04/2025 si dhe ankesa e OE “Pro & Co Group” SH.P.K., me nr. 2025/0238, e datës 04/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi I projektit të integruar të Bulevardit të qytetit Gjilan”, me numër të prokurimit 651-25-644-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL-GJILAN”.
2. Mbetet në fuqi njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi I projektit të integruar të Bulevardit të qytetit Gjilan”, me numër të prokurimit 651-25-644-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL- GJILAN”.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

### ***- Faktet dhe rrethanat procedurale -***

Me 17.03.2025, “KUVENDI KOMUNAL-GJILAN”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka dërguar ftesën për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi I projektit të integruar të Bulevardit të qytetit Gjilan” me nr.prokurimi: 651-25-644-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 18,000,000.00 €.

Me 29.03.2025, OE “SEMAKS” SH.P.K., si dhe me datën 29.03.2025 OE “Pro & Co Group” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 04.04.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar te dy kërkesat për rishqyrtim.

Me 04.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “SEMAKS” SH.P.K., me nr. 2025/0237 si dhe OE “Pro & Co Group” SH.P.K., me datën 04.04.2025 me nr.2025/0238 lidhur me aktivitetin “Ndërtimi I projektit të integruar të Bulevardit të qytetit Gjilan” me numër të prokurimit 651-25-644-5-1-1.

### ***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “SEMAKS” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Me date 18.03.2025 është publikuar njoftimi për kontrate ku ne si OE kemi shpreh interesim për pjesëmarrje, e kemi analizuar në detaje këtë projekt dhe kemi vërejtë se ka shkelje të dispozitave të LPP-se dhe diskriminim tek kërkesat e dosjes së tenderit saktësisht Kapaciteti teknik dhe profesional:

KERKESA 1: Kërkesa 1. Operatori ose grupi i OE duhet të ofroj deshmi se ka perfunduar me sukses kontrata për projekte të ndërtimit të natyrës së ngjashme në vlerë prej 15.000,000.00 euro, ndërsa prej tyre 6,000,000.00 euro duhet të janë punë në projekte të ndërtimit të nënkalimeve. Në rast të grupit, lideri duhet të ketë së paku 2 referenca në ndërtimin e projekteve të nënkalimeve.

Kjo kërkesë duhet të korigjohet sepse kërkesa për punë të nënkalimeve 6 milion është diskriminuese sepse sikurse punët e nënkalimeve të ngjashme janë edhe punët e rrugëve dhe punët ndërtimore të objektet ose parkinget e ndryshme andaj kërkojmë që të largohet kriteri për nënkalime sepse punët janë të ngjashme sikurse tek punët e tjera. Pra edhe puna në nënkalime hyn në kuadër të punëve të ndërtimit, prandaj kjo kërkesë është shumë kufizuese dhe duhet të ndryshohet me qëllim të hapjes së konkurrencës.

KERKESA 2: Kërkesa 5. OE duhet të jetë i certifikuar me certifikata si në vijim:

a) OE duhet të ofroj certifikaten e qendrueshmerise se performances dhe konformitetit (EN 40-5 2002-1608-CPR-P033 valide) duke bashkangjitur Certifikaten e karakteristikave të produkteve 6.8m, 12.8m për shtylla konike ndriqimit.

Kjo kërkesë është diskriminuese sepse këto karakteristika i ofrojnë kompanitë që janë prodhues të shtyllave, prandaj prodhuesit janë të certifikuar me këto standarde e nuk ka arsye që të jetë i certifikuar edhe operatori ekonomik, por e rëndësishme është që të gjitha materialet që do të përdoren do të ofrohen sipas kërkesave të projektit dhe të miratuara nga menaxheri i projekti.

Mbi këtë bazë vlerësojmë se duhet të largohet kjo kërkesë pasi që është shumë favorizuese dhe njëkohësisht kufizuese për shumë OE.

Certifikata duhet të jete në emër të OE i cili aplikon ose duhet të ketë autorizim për certifikaten në fjalë.

Këto certifikata janë plotësisht të panevojshme që ti posedojnë OE, madje këto certifikata nuk ka nevojë që të ofrohen as nga një autorizues apo distributor, pasi që me standardet në fuqi secili prodhues që i prodhon shtyllat përkatëse i nënshtrohet rregullativave ligjore dhe plotësimit të standardeve përkatëse.

b) OE duhet të ofroj certifikaten për kontaktore me standardin IEC 60947-4 2009 dhe ndërprerës për orman me standardin IEC 60947-3 2020.

Gjithashtu edhe kjo kërkesë është diskriminuese sepse këto certifikata i ofrojnë kompanitë që prodhojnë këto materiale dhe të gjitha materialet që përdoren do të jenë sipas kërkesave të projektit dhe të miratuara nga menaxheri i projekti. Nuk duhet kërkuar standarde nga ofertuesi, pasi që ky tender ka të bëjë me ndërtim e jo me shtylla ose materiale elektrike, prandaj në këtë rast çdo herë ndodh bashkëpunimi me kompanitë e specializuara në fushat përkatëse, e të cilat i mbajnë përgjegjësitë për furnizimet apo shërbimet të cilat i ofrojnë ato.

Kërkojmë që të lrohet kjo kërkesë nga dosja e tenderit.

#### KERKESA 3: Kërkesa 4. Lista e paisjeve

Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.

#### Deshmia 4. Lista e pajisjeve

OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e paisjeve duke plotësuar Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit e nënshkruar dhe vulosur nga OE.

Për automjetet që nuk regjistrohen nga pika (1-21) Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes, të gjitha ato mjete që paraqiten me fature të blerjes duhet të kenë të bashkangjitur edhe transaksionin bankar.

Për automjetet që regjistrohen nga pika (22-35) Librezat e qarkullimit me validitet.

Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronesinë OE duhet të ofroj marreveshjen për marrjen me qira të pajisjeve me deshmite sipas kërkesës me lartë. Marreveshja duhet të jete në emër të

ketij projekti me validitet te kohezgjatjes te ketij prjekt e nenshkruar dhe vulosur nga te dyja palet.

#### ANEKSI 7. Lista - PAJISJET DHE MEKANIZIMII NEVOJSHËM

Vërejtje: Mbetet obligim i Kontraktorit që, përveç pajisjeve dhe makinerive të listuara më poshtë, të sigurojë edhe pajisje dhe makineri tjera për të cilat kontstohet (nga Autoriteti Kontraktues apo vet Kontraktori) se janë te nevojshme për ekzekutimin e punëve sipas sasisë, cilësisë dhe dimaiks së kontraktuar.

#### PAJISJET DHE MEKANIZIMII OBLIGUESHËM PËR PROJEKTIN ME TITULL:

Kjo liste e pajisjeve dhe makineritë e kërkuara janë diskriminuese për shumë OE te interesuar për të marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, sepse pajisjet dhe makineria e kërkuar nuk kanë lidhshmëri me natyrën dhe qëllimin e projektit dhe pozicioneve në paramase, andaj kërkojmë nga AK që këto kërkesa të korrigjohen dhe një pjesë të largohen krejt sepse janë te panevojshme dhe se shpien drejt favorizimit të një kompani të caktuar dhe mundësisë së keqpërdorimit të buxhetit.

Janë kërkuar disa pajisje sikur të jetë tenderi për ndonjë projekt me elektrikë, e disa pajisje janë kërkuar që nuk kanë fare të bëjnë me ndonjë pozicion, prandaj këto duhet ët ndryshohen me qëllim që të ketë konkurrencë të hapur

KERKESA 4: KUVENDI KOMUNAL- GJILAN ka publikuar tenderin ne fjale me date 18/03/2025, ku sipas dosjes se tenderit afati i fundit per dorëzimin e tenderëve është data 07/04/2025. Me rastin e përcaktimit te afatit te fundit per dorëzimin e tenderëve, AK ka vepruar ne kundershtim me Nenin 44 dhe Nenin 45 te LPP. Sipas dispozitave te Nenit 44 te LPP, ne rastet e kontratave me vlere te madhe, AK duhet qe te mbaje tenderin te hapur ne nje afat jo me pak se 40 dite. Ndërsa ne rastet kur ka njoftim paraprak, atëherë tenderi duhet te jete i hapur ne një afat jo me pak se 24 dite. Afati i fundit i caktuar nga Autoriteti Kontraktues është me i shkurtër se 40 dite, dhe me i shkurtër edhe se 24 dite.

Autoriteti kontraktues nuk ka pas parasysh faktin se afatet për ofertim të janë në harmoni me natyrën dhe qëllimin e projektit gjithnjë duke pasur parasysh kërkesat e shumta që duhet të plotësohen për të përgatitur një ofertë serioze.

Kërkojmë nga OSHP-ja qe të detyrojë AK-së të korrigjojë dosjen e tenderit dhe të hiqen disa kërkesa ne te kundërtën do te veprojmë sipas ligjeve ne fuqi dhe do te ndjekim rrugën tone ligjore edhe ne instanca me te larta.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk janë marr parasysh as neni 17.17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesi e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”.

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë;

(i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”. Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe kët kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bien në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, ku shkruan qartë se “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”.

Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomik financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit dhe të merret parasysh edhe dispozita e lartpërmendur (25.4 te Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik)

Pra, në vend se të merret parasysh edhe zhvillimi i operatorëve ekonomik të rinjë, janë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë, me më shumë përvojë në këtë fushë siç është ky aktivitet i prokurimit.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 1 të LPP-së- qëllimi i LPP-së, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “SEMAKS” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelir nenin Neni 1 Qëllimi, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe Transparenca, Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje, Neni 45 - Rregullat e posaçme për përcaktimin e afatit kohor për pranimin e tenderëve të një kontrate publike të përfshirë nga një njoftim paraprak Neni 69 Kapaciteti teknik dhe professional. Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr: VENDIM të APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE: SEMAKS SH.P.K. me NUI:812150332 me seli në Prizren. Obligohet AK: KUVENDI KOMUNAL- GJILAN që të bëjë korrigjimin e dosjes konform dispozitave të LPP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Pro & Co Group” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

1. Kriteri 9.1 dhe 9.2 - Operatori ose grupi i OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të ndërtimit të natyrës së ngjashme në vlerë prej 15.000,000.00 euro, ndërsa prej tyre 6,000,000.00 euro duhet të jenë punë në projekte të ndërtimit të nenkalimeve. Në

rast te grupit, lideri duhet te kete se paku 2 referenca ne ndertimin e projekteve te nenkalimeve.

Ky kriter është diskriminues dhe i panevojshëm lidhur me këtë tender, pasi që në baza paramasës dhe vet titullit të tenderit, “Projekti integrues i sheshit, parkingut nëntokësor dhe objektit të administrates”. Pra, përderisa shumica dërmuese e punëve ka të bëjë me ndërtimin e sheshit, parkingut dhe objektit të administratës, është e pakuptueshme se si është vendosur si kriter edhe vlera prej 6 milion eurosh në ndërtimin e nënkalimeve.

Poashtu, duhet të hiqet kriteri se lideri duhet të ketë së paku dy (2) referenca në ndërtimin e projekteve të nënkalimeve, pasi që konzorciumet krijohen për qëllim të plotësimit të kriterëve në mënyrë sa më të mirë nga anëtarët e konzorciumit, dhe ky kriter i’a heqë vet esencën defmicionit të konzorciumit.

Andaj, kërkojmë që kriteri të ndryshohet dhe të formulohet në këtë formë Operatori ose grupi i OE duhet te ofroj deshmi se ka perfunduar me sukses kontrata per projekte te ndertimit te natyres se ngjashme ne vlere prej 15.000,000.00 euro. Ose Operatori ose grupi i OE duhet te ofroj deshmi se ka perfunduar me sukses kontrata per projekte te ndertimit te natyres se ngjashme ne vlere prej 15.000,000.00 euro, ndersa prej tyre 6,000,000.00 euro duhet te jene pune ne projekte te ndertimit te nenkalimeve. Ne rastte grupit, njëri nga anëtarët e grupit duhet te kete se paku 2 referenca ne ndertimin e projekteve te nenkalimeve.

1. Kriteri 9.1 dhe 9.2. Kërkesa 2. OE duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon: Nje bachelor i diplomuar i hidroteknikes i certifikuar ne AME per mbrojtje nga zjarri (min 5 vite pervoje pune nga data e certifikimit).

Kjo kërkesë është tërësisht e kundërligjshme dhe favorizuese oër OE të caktuar (kryesisht të huaj), pasi që këto certifikata në Kosovë, kanë filluar të lëshohen vetëm në dy vitet e fundit, dhe nuk janë lëshuar më herët, andaj është edhe e pamundur që të posedohen me këtë validitet.

Poashtu, edhe nëse një bachelor i diplomuar i hidroteknikës, nuk e ka këtë certifikatë, OE është i detyruar që sipas Nenit 13 të Kontratës, të ofrojë siguri në vendpunishte. Për më tepër, këto detyrime caktohen edhe nga Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë. Andaj, kjo kërkesë duhet të ndryshohet dhe të hiqet nga kriteret e DT.

Kriteri Kriteri 9.1 dhe 9.2: Kërkesa 5. OE duhet të jetë i certifikuar me certifikata si në vijim:

a) OE duhet te ofroj certifikaten e qendrueshmerise se performances dhe konformitetit (EN 40-5 2002-1608-CPR-P033 valide) duke bashkangjitur Certifikaten e karakteristikave te produkteve 6.8m, 12.8m per shtylla konike ndriqimit. Certifikata duhet te jete ne emer te OE i cili aplikon ose duhet te kete autorizim per certifikaten ne fjale;

b) OE duhet te ofroj certifikaten per kontaktore me standardin IEC 60947-4 2009 dh nderpreres per orman me standardin IEC 60947-3 2020,

Këto certifikata, nuk shërbejnë fare për objektin e kontratës, meqë të njëjtat përdoren vetëm në rastet kur tenderët përfshijnë në shumicën dërmuese elemente elektrike, si në KEK, KEDS, apo institucione tjera të energjisë. Në rastin konkret, janë plotësisht të panevojshme, meqë të gjitha përfshijnë elemente të punës në energji elektrike dhe jo në punë ndërtimore.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Pro & Co Group” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelir nenin Neni 1 – Qëllimi Neni 7 - Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi Neni

10 - Mjetet për promovimin e performance Neni 28 - Specifikimet teknike Neni 51 - Njoftimi i kritereve të përzgjedhjes Neni 69 - Aftësia teknike dhe/ose profesionale. Dhe kërkojm APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik Pro & Co Group Sh.P.K. OBLIGOHET AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsytimit të dhëna nga OE.

Përgjigje e Autortetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: “Pro & Co Group” SH.P.K., dhe OE SEMAKS SH.P.K,

Operatorët ekonomik të pakënaqur me kushtet e Dosjes së Tenderit, ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK- Komunës së Gjilanit, ashtu që ka konsideruar se dosja e tenderit lidhur me kërkesat e kapacitetit profesional paraqet kufizim të konkurrencës sipas LPP-së, andaj edhe kanë propozuar largimin e tyre. Duke u referuar pretendimeve të theksuar në kërkesat e tyre, OE-të ankues konsiderojnë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7,44,45,69,51.52,56,27 të LPP duke kërkuar korrigjimin e dosjes së tenderit në këto pika.

OE ankues edhe pse sipas DT-së dhe NJK-së. kanë pasur afatin e përcaktuar për sqarime shpesh të D1 -së, por asnjë nga OE ankues nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e tyre ligjore, por pas përfundimit të afatit për sqarime shpesh të DT-së, kanë parashtruar kërkesa për rishqyrtim, po ashtu asnjë nga OE-të ankues nuk janë paraqitur për ta tërhequr projektin në Ak, edhe pse një gjë të tillë si informata e kanë të vendosur në Dosjen e tenderit, kjo le të kuptohet se pretendimet ankimore janë të pabazuara dhe nuk paraqesin fakte por janë në formë sugjeshive dhe jo parimore. AK - Komuna e Gjilanit konstaton se Kërkesa për Rishqyrtim e OE-ve ankues janë ushtruar brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 108/A paragrafi 3.1 të LPP sipas procedurës paraprake për zgjidhjen e mosrrethësive dhe si të tillë i përmban elementet e përcaktuara me nenin 60 paragrafi 3 të Rregullorës Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik. Në këtë mënyrë Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të AK - Komuna e Gjilanit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë kërkesë sipas nenit 108/A të LPP dhe se nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

#### ***- Konstatimet e AK-së bazuar në faktet dhe rrethanat e rastit -***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike në mënyrë objektive dhe ligjore, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nga ana e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Gjilanit, ka bërë shqyrtimin e pretendimeve ankimore bazuar në argumentet e paraqitura në kërkesat për rishqyrtim të parashtruar nga OE-të ankues në kontekstin e përgjithshëm të fakteve dhe shkresave të lëndës, dhe duke marrë parasysh se pretendimet e lartcekura të OE -ve ankues janë të ndërlidhura me objektin e njëri-tjetrit, është vendosur që të trajtohen dhe shqyrtohen si tërësi, bashkërisht, duke pasur parasysh natyrën, specifikat/kërkesat të parapara në këtë aktivitet.

Prandaj AK, konstaton se sa i përket pretendimeve ankimore të parashtruara nga ana e juaj si OE lidhur me kërkesat e dosjes së tenderit për të cilat aludoni se kërkesat janë kërkesa diskriminuese apo kufizuese, ianc të pabazuara, dhe rrjedhimisht nuk mbështeten me asnjë fakt apo provë të argumentuar, se kjo kërkesa e kufizojnë konkurrencën e lirë në treg dhe diskriminon OE-të ankues apo OE potencial që mund të aplikojnë në këtë aktivitet të prokurimit. Kjo për faktin se, të gjitha kërkesat dhe kushtet e dosjes së tenderit sipas versionit të korrigjuar të dt. 26.03.2025, janë kërkesa relevante dhe proporcionale me objektin e projektit, të cilat garantojnë respektimin e parimeve të transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë duke mos lejuar kurrfarë avantazhi për konkurrent të caktuar. Por si të tilla sigurojnë një nivel të lirë dhe të përshtatshëm të konkurrencës së barabartë për të gjithë OE potencial që dëshirojnë të aplikojnë në këtë aktivitet prokurimi.

Kjo situatë vërtetohet edhe nga fakti se, të gjitha kushtet dhe kërkesat materiale të dosjes së tenderit duke përfshirë edhe këto që janë ngritur si pretendime nga ana e juaj, janë konformë projektit dhe pozicioneve të cilat janë paraparë për ekzekutimin e punimeve.

Prandaj AK, duke analizuar pretendimet ankimore të secilit OE ankues, dhe duke parë se pretendimet janë të njëjta do të trajtohet bashkërisht.

Lidhur me pretendimet ankimore nga OE-të për shkurtime të afatit kohor.

Përgjigje nga AK: Autoriteti Kontraktues ka vendosur të vazhdojë këtë aktivitet të prokurimit me afatin e shkurtuar duke u bazuar dhe mbështetur në situatën të cilën gjendet për këto arsye:

Ky aktivitet i prokurimit bazohet në Marrëveshjen për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Gjilanit, me nr. protokollin 02-8090, datë 23.12.2024, Ky projekt është një nga iniciativat kryesore për rregjenerimin urban të qendrës së qytetit dhe ndërtimin e objektit të ri të administratës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e projektit dhe faktin që është një projekt afatgjatë, shkurtimi i afatit kohor është bërë për arsye objektive dhe të arsyeshme, si vijon

#### 1. Vonësia në aprovimin e buxhetit

Buxheti i Komunës së Gjilanit është aprovuar në Asamblencë Komunalë vetëm në muajin Mars, gjë që ka ndikuar që si Autoriteti Kontraktues (AK) të mos mund të iniciojë aktivitetet e prokurimit në kohën e duhur.

Për pasojë, vonesat e krijuara kanë imponuar nevojën për të shfrytëzuar mundësinë ligjore të shkurtimeve të afatit të dorëzimit të ofertave për të mos rrezikuar realizimin e projektit brenda kushteve optimale klimatike.

#### 2. Kushtet klimatike

Ky projekt përfshin ndërhyrje të ndjeshme në qendrën e qytetit, në hyrje-daljet e saj, në zonën rekreative si Parku i Qytetit, dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në infrastrukturën dhe sigurinë e qytetarëve.

Për shkak të kushteve të vështira klimatike gjatë dimrit, është thelbësore që procedurat e prokurimit të përmbyllen sa më shpejt. Në mënyrë që punimet të mund të zhvillohen në një periudhë të favorshme për realizimin e tyre me cilësi të lartë.

#### 3. Ndikimi në qytetarë dhe zhvillimin urban

Zgjatja e pavarësisht e procedurave mund të vonojë një projekt kyç për përmirësimin e infrastrukturës dhe estetikës urbane të qytetit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e tij për qytetarët dhe ndikimin e tij në konfortin dhe sigurinë publike, është e domosdoshme të sigurohet fillimisht sa më i shpejtë i punimeve

Po ashtu për të njëjten pretendim ju si OE ankues, AK e ka njoftuar edhe KRPP, lidhur me shkurtime të afatit kohor dhe kemi sqaruar arsyet dhe argumentet për këtë aktivitet.



Lidhur me pretendimet ankimore nga OE-të ankues, për kapacitet teknike/profcsione dhe paisjet ç kërkuara të cilat janë vendosur në DT.

Përgjigjejt nga AK:

Kërkesa I. I )Tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar “Kërkesa 1. Operatori ose grupi i OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të ndërtimit të natyrës së ngjashme në vlerë prej 15.000,000.00 euro, ndërsa prej tyre 6,000,000.00 euro duhet të jenë punë në projekte të ndërtimit të nënkalimeve. Në rast të grupit, lideri duhet të ketë së paku 2 referenca në ndërtimin e projekteve të nënkalimeve”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar

“Dëshmia 1. Një listë e kontratave të nënshkruar dhe vëltur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pranimin teknik kopje për kontratat e prezentuara,

Nëse kontrata me reference është me kompani private të dëshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është përfunduar pagesa). Referencat apo pranimet teknike duhet të jenë në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat”.

Pretendimi 1: Kërkesa e lartcekur është kërkesë diskriminuese ku është kërkuar që pothuajse gjysma e kontratave të përfunduara të jenë punë në projekte të ndërlimit të nënkalimeve. Kur analizohet dosja e tenderit të këtij aktiviteti të prokurimit shihet qartë se në këtë aktivitet të prokurimit puna kryesore ka të bëjë me ndërtim të bulevardit dhe jo vetëm me ndërtim të nënkalimeve. Për më tepër, duket qenë se në vendin tonë ndërtimi i nënkalimeve është relativisht i rrallë, kjo kërkesë duket se favorizon kompani të caktuara që tashmë kanë realizuar kontrata të tilla, duke lënë jashtë gare operatorë të tjerë të kualifikuar. Kjo kërkesë bie ndesh me parimet e prokurimit publik për transparencë, konkurrencë dhe barazi në trajtim përkatësisht me nenin 7 të LPP-së. Duhet përmendur fakti që Ligji për Prokurimin Publik, përkatësisht neni 7 i këtij ligji kërkon që kërkesat të cilat vendosen nga autoriteti kontraktues duhet të mundësojnë pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomik dhe shmangin e kufizimeve të panevojshme Një kërkesë e tillë duhet të jetë më gjithëpërfshirëse dhe të reflektojë më saktë realitetin e tregut, duke lejuar konkurrencë më të gjerë me operatorëve me përvojë relevante në ndërtim, jo vetëm në një segment të veçantë siç janë nënkalimet. Për këtë arsye, një ndryshim i kërkesës së lartcekurduke u larguar në tërësi kërkesa për prezantimin e kontratave të përfunduara për ndërtim të nënkalimeve është i domosdoshëm për të garantuar një proces të drejtë dhe të hapur për të gjithë pjesëmarrësit e mundshëm.

1) Përgjigjia e AK: Bazuar në projektin integruar të bulevardit nëse e analizoni parametrit ose projektin të cilin ju kemi dhënë mundësinë të tërhiqni në zyret e prokurimit, mund të vini re se ky projekt ka të bëjë me ndërtimin e tre objekteve të ndryshme si janë ai i sheshit, parkingut nëntokesor dhe Objektit të administratës. Duket marrë parasysh se projekti i nënkalimit dhe i garazhave në kuadër të këtij nënkalimi kap vlerën kryesore të projektit dhe volumin më të madh të punëve krahasuar me dy projektet tjera që janë bulevardi si dhe administrata, atëherë AK. e ka parë të nevojshme që OE të cilat paraqesin ofertën e tyre të jenë kompani që kanë përvojë në realizimin e projekteve të natyrës së njëjtë, andaj ka kërkuar që një pjesë e tyre në vlerë prej 6,000,000.00 euro të jenë projekte të nënkalimeve. Pra duket marrë për bazë që pjesa dërmuese e projektit ka të bëjë me ndërtimin e nënkalimit dhe garazhave AK këtë pretendim e sheh si të pabazuar dhe jo diskriminues.

## Pretendimi 2.

2)Një bachelor i diplomuar i hidroteknikës i certifikuar në AME për mbrojtje nga zjarri (min 5 vite përvojë pune nga data e certifikimit) Ku në dosjen e parë të publikuar nga AK ky kriter ishte me min 8 vite, tash i ndryshuar me 5 vite! Ne hasim ne nje parrcgullesi dyshimi qe ky tender mund te jete i pregaditur per OE i cili ka ne staf kcte bachelor, i cili per qudi ka nje certifikate te marr qe 5 vite, andaj edhe kerkesa i eshte pershtatur te njejt, AE mund te kerkoje bachelor apo ingjnier te hidroteknikes mirpo smundet te caktoj qe i njejt te bazohet ne daten e certifikimit! Aq me pak qe ne piket c veq se eshte kerkuar nje Hidro dhe nuk c parashohim te nevojshme kerkesen per 2 Hidro, mund te kerkohen persona me trajnime apo licensim nga lemia e sigurise ne punc apo mbrotjes nga zjarri..

2.Pergjigja e AK: Sa i perket pervojës së punës nga 8 ne 5 vite, AK e ka ndryshuar këtë kërkesë duke c bërë më të lehtë me qëllim që të mundësohet pjesëmarrje sa më e gjerë e operatorëve ekonomik. Ndërsa sa i perket pretendimit se nuk e parashohim të nevojshme kërkesën pasi që të pika c veq se është kerkuar një Hidro, ju bëjmë me dije se pika c ka të bëjë me inxhinier të diplomuar sistemi 5 vjeçar ose master ndërsa kjo pike plotësohet edhe me bachelor. AK do të kërkoje përvojë për stafin profesional kur e sheh të nevojshme njëjt siq ndodh zakonisht edhe me menagjimin e projektit apo stafin tjetër, ndërsa 5 vite është përvoja minimale e cila mund të kërkojë andaj ky pretendim është i pabazuar dhe jo diskriminues.

## Pretendimi 3.

OE duhet të paraqes në list të punëtorëve min.60 punëtor të stafit teknik (ne rast te grupit lideri duhet ti kete min 50 punetor) te deshmuar me listen e administrates tatimore te Republikes se Kosoves,se paku ne dy muajt e fundit 2024, ne mcsin c te cileve duhet Operatori ekonomik duhet të ketë slatë teknik në të cilët mund të thirret për realizimin e këtij projektit : Kerkese e papranueshme edhe njeherazi AK mund te kerkoje staf (fuqi punetore) me numer ta pacaktuar mirpo nuk mund te specifikojte se keta punetore te kene qene te deklaruar ne dy muajt e fundit te vitit 2024, pasi po ballafaqohemi me nje shkelje te rende duke ngushtuar keshtu Konkurrencen e lire e cila nuk eshte qellimi i vet ligjit te prokurimit!

3.Pergjigja e AK: Duke marre parasysh se ky projekt është ndër projektet më të mëdha të qytetit të Gjilanit sa i përkelë edhe vlerës edhe rëndësisë së projektit, AK e sheh të nevojshme që OE të cilat shprehin interesimin për ta realizuar këtë kontratë të jeni OE të pajisur me numër të madh të slafil Teknik ashtu që projekti të realizohet sipas planit dinamik. Duket qenë se OE shpesh lidhin marrëveshje apo parakontrata me stafin vetëm sa për ti plotësuar kriteret e dosjes dhe pastaj kur fillon realizimi i projekteve hasim në mungesë të stafit, AK e ka konsideruar të nevojshme që të dëshmojnë me listë të ATK për tu bindur se OE stafin e njëjtë e ka në kuadër të kompanisë së tij.

Ndërsa për mos ta kerkuar dëshmin për periudha me afatgjata dhe për ta bërë më të lehtë e kemi kerkuar vetëm dy muajt e lundil të vitit 2024.

## Pretendimi 4.

Min. 1 teknik i ndertimit te larte te shkalles se IV. i cili duhet te jete i trajnuar nga lemia e sigurisë dhe shëndetit ne pune si dhe e mbrojtjes kunder zjarrit. Qka perfsheh shkalla e 4 ? a nenkuptojm me shkolle profesionale. pasi ky kriter te ve ne medyshje.

4. Pergjigjja e AK: Nënkuptohet shkollë e mesme profesionale për të cilën duhet të dëshmohet me diplomë se ka përfunduar profilin arsimor teknik i ndërtimit të lartë.

Pretendimi 5.

Nje bachelor i certifikuar si specialist i avancuar per siguri dhe shendet ne pune ne industrine e ndertimit. Po ketupse duhet te vendoset bachelor? Apo nenkupton graden profesionale te personit e cila mund te mos ketë lidhje me certifikimin si specialist? Ju lutem ta qartësoni

2. Pergjigjja e AK: Nënkuptohet që përveq qertifikatës si specialist i avancuar për siguri dhe shëndet në punë ne industrine e ndërtimit, la këtë edhe nivelin e studimeve bachelor të cilido profil të dëshmuar me diplome .

Sa i përketë 1 istës së paisjeve sipas Aneksit 7, ku OE-të ankues kanë atakuar paisjet e vendosura në DT.

Përgjigjejet nga AK:

Pretendimi: Vinç-ashensor me konstruksion metalik për bartjen dhe ngritjen e materialeve elektrike dhe me trupa të ashensorit deri në 40m Pretendimi Pajisja e kërkuar është e panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit dhe e njëjta duhet të largohet në tërësi nga dosja e tenderit për faktin se bulevardi është një projekt horizontal, jo vertikal, andaj edhe nuk ka nevojë për transport në lartësi të mëdha.

Përgjigjja e AK: Përveq bulevardit dhe nënkalimit që janë projekte siq i quani horizontale, pjesë përbërëse e këtij projekti është edhe ndërtimi i objektit të administratës e që po ta analizoni projektin ky objekt është me etazhitet n=7 kate , prandaj AK e shih të nevojshme këtë kërkesë.

Pretendimi: Automikser vetëngarkues për prodhimin e betonit Pretendimi Ky lloj mikseri paraqet disa dobësi të konsiderueshme në krahasim me përdorimin e mikserëve standardë, të cilët furnizohen drejtpërdrejt nga kompanitë e specializuara për prodhimin e betonit të gatshëm. automikseri vetëngarkues nuk mund të ofrojë të njëjtin nivel të cilësisë dhe kontrollit të përbërjes së betonit si kompanitë e specializuara. Prodhimi i betonit në kushte jo-industriale mund të rezultojë në variacione në përzicje dhe cilësi. ngase me automikser vetëngarkues përzicja e betonit bëhet në terren aty për aty.

Përgjigjja e AK: Patjetër që betonimi i elementeve të strukturës do të bëhet përmes furnizimit nga kompanitë e specializuara. Por në këtë projekt do të ekzekutohen edhe elemente të vogla në terene të papërshtatshme siq janë pushtat, fundet e pushtave, skajoret nga betoni etj etj prandaj AK e shih të nevojshme posedimin edhe të një paisje të tilla.

Pretendimi: Një vinç hidraulik për ngarkim/shkarkim të automjeteve zakonisht përdoret për riparimin e automjeteve të dëmtuara ose për logjistikë transporti, jo për punë ndërtimore. Në projektin e ndërtimit të një bulevardi, nuk ka nevojë për një mjet të tillë, sepse materialet ndërtimore si betoni, çeliku dhe elementët modularë mund të ngarkohen/shkarkohen nga vinça të tjerë ndërtimorë (p.sh., vinç kullë ose vinç mbi kamion). Automjetet që do të lëvizin në bulevard janë pjesë e trafikut publik dhe jo të ndërtimit, prandaj nuk ka arsye të kërkohe: një vinç për to.

Kjo pajisje rrit kostot e projektit duke detyruar operatorin ekonomik të sigurojë një mjet që mund të mos përdoret fare gjatë punimeve. Investimi në këtë mjet është joefikas, pasi vinçat e

zakonshtëm ndërtimore ose makineri të tjera (p.sh. ekskavatorët me krah të gjatë) mund të mbulojnë të gjitha nevojat e ngarkim-shkarkimit të materialeve të ndërtimit. Kjo makineri nuk është praktike për punimet ndërtimore të një bulevardi.

Përgjigjia e AK: Kërkesa në thelb ka të bëjë me vinq hidraulik për nga natyra e punës i cili do të përdoret për ngarkimin dhe shkarkimin të të gjitha materialeve të nevojshme siq janë: cementet e shallonave, makineritë e ndryshme për ekzekutim të punës përfshirë edhe automjetet e punës. Pra mjafton të jetë hidraulik dhe të shërbejë për ngarkim dhe shkarkim, AK do ta pranojë këtë kërkesë.

Pretendimi: Instrument për certifikim dhe testim të kabllave (Multimates TESTPRO CV100-K50 COPPER CERTIFICATION KIT) pretendimi nga OE kur analizohet paramasa e vendosur në platformë, me emër PARAMASA DHE PARALLOGARIA-ELEKTRIKA (NDRICIMI I JASHEM), e njëjta është parallogari për ndriçimin e jashtëm. Andaj në këtë rast pajisja Multimates TESTPRO CV100-K50 Copper Certification Kit nuk është e nevojshme dhe adekuat për këtë projekt. Arsyeja kryesore është se ky instrument përdoret për certifikimin dhe testimin e kabllave të të dhënave (p.sh.. Ethernet, telekomunikacion, rrjete kompjuterike), ndërsa ky projekt fokusohet në ndriçimin publik dhe kabllot energjetike. Projekti është për ndriçim të jashtëm - Paramasa përfshin furnizim dhe montim të kabllave energjetike për furnizimin e ndriçuesve LED dhe pajisjeve ndriçuese publike, jo kablo të të dhënave që kërkojnë certifikim të avancuar. Kabllot e përfshira në këtë aktivitet të prokurimit janë kryesisht energjetike - Specifikimet tregojnë përdorimin e kabllave si NYY-J dhe NYY-J, të cilat janë për energji elektrike dhe jo për rrjete të komunikimit apo të dhënash. Ky aktivitet i prokurimit nuk përfshin vendosjen e infrastrukturës së rrjeteve LAN ose sistemeve të telekomunikacionit që kërkojnë certifikim të tillë. Autoriteti kontraktues më kërkesën e lartcekur po ju pamundëson ofertimin kompanive të interesuar dhe me shumë përvojë në fushën e ndërtimit, ndërsa po i favorizon OE të cilët posedojnë këtë pajisje, e cila siç e cekëm është e panevojshme kur analizohet paramasa e këtij aktiviteti të prokurimit.

Paramasa e këtij aktiviteti të prokurimit përfshin furnizimin dhe lidhjen e kabllave elektrike të tensionit të lartë dhe të ulët (kablo bakri dhe alumini). Përfshihet gjithashtu kablloja optike OM3 single mode inc 6 fije, e cila kërkon testim specifik. Lidhja dhe saldimi i kokave LC për fiber optike. Multimates TESTPRO CV100-K50 Ky instrument është i specializuar për certifikimin dhe testimin e kabllave bakri për rrjete Ethernet (CAT5e, CAT6, CAT6A, etj.). Ai nuk është i përshtatshëm për testimin e kabllave optike, për të cilat zakonisht përdoret një OTDR (Optical Time Domain Reflectometer). Nëse qëllimi është testimi i kabllave elektrike ose kabllave optike.

Për kabllot elektrike, zakonisht përdoren megohmetra (për izolim) ose testues të rrymës dhe tensionit. Për kabllot optike, duhet një OTDR. Kërkojmë që të ndryshohet kërkesa e lartcekur duke e larguar në tërësi kërkesën e kontestuar më lartë për faktin se e njëjta është e panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigjia e AK: Gjatë ekzekutimit të punëve dihet se lokacioni i vendpunishtes është pikërisht qendra e qytetit. Për ta hapur gropën ndërtimore të nevojshme për ekzekutimin e nënkalimit dhe garazhave do të jetë e nevojshme të bëhen shumë dislokime apo zhvendosje të instalimeve nga me të ndryshmet (jo të gjitha të parashikuara apo të zbatuara në bazë të ndonjë projekti zbatues), të cilat aktualisht janë të vendosura në sipërfaqen e tokës përfshirë këtu edhe kablo të të dhënave.

Në anën tjetër nëse e analizoni me kujdes paramasën mund ta vini re se projekti nuk ka të bëjë vetëm me ndriqim publik. Paramasa e instalimeve elektrike ndahet në disa pjesë siq janë elektrika në objektin e administratës, elektrika dhe nënkalimi dhe elektrika që ka të bëjë me ndriqimin e jashtëm. Ashtu siq edhe ju pretendoni se Mullimates TESTPRO CV100-K50 Ky instrument është i specializuar për certifikimin dhe testimin e kabllove bakri për rrjetet Ethernet (CAT5e, CAT6, CAT6A. etj.), irjallon një rishikim i shpejtë për ta kupluar se pjesë e instalimeve elektrike janë edhe rrymat e dobëta siq janë sistemi i teknologjisë informative, sistemi i telefonisë, CCTV, sistemi i kontrollit të qasjes etj etj ku në të gjitha këto kemi të bëjmë me kablo bakri për njëte.

Shiko tek Elektri i Administratës pozicionet: pos 4.6.1, pos 4.7.1, pos 4.9.4, pos 4.10.9, Shiko tek Elektri dhe nënkalimi pozicionet: XI - sistemi i videobikujqyrjes POS 10 , XII - sistemi i teknologjisë informative POS 1.

Pretendimi: Traktor me fshise për pastrim. Max 1.5T sipas OE në pretendimet e tyre se kjo pajisje është më e përshtatshme për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe rrugëve lokale, se sa për një projekt të madh infrastrukturor si ndërtimi i Bulevardit të Gjilanit. Kërkesa për këtë mjet nuk përputhet me nevojat reale të projektit. Një mjet i tillë zakonisht përdoret për pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike pas përfundimit të ndërtimit. Përfshirja e tij si kriter të ndërtimit nuk është e nevojshme dhe paraqet një përkufizim të konkurrencës, pasi që është e palogjikshme të kërkohej ky mjet kur projekti do të ekzekutohet dhe pjesa e pastrimit do të bëhet krejtësisht në fund të projektit dhe se kur të përfundohet ajo do të pastrohet nga kompania e pastrimit të cilën e ka të kontraktuar komuna e Gjilanit.

Përgjigjja e AK: Marrë për bazë faktin se punimet do të zhvillohen në qendër të qytetit, gjatë stinës së verës kur edhe punimet priten të jenë duke u zhvilluar dhe niveli i pluhurit do të jetë shumë i madh, mund të kërkohej nga OE që hapësirën rreth punës të mirëmbajë herë pas here.

Pretendimi: për Gjysmërimorkio special me 2 pompa për deblokimin e kanalizimit dhe zbrastjen e pusetave me presion min. 200 bar me kapacitet 5000 litra. Pretendimi Për ne si operator është e pakuplimentë kjo kërkesë, kur kemi parasysh faktin se në treg ekzistojnë kamion të cilët janë shumë më të avancuar të cilët kryejnë edhe këtë punë me më shumë efikasitet. Pra nuk ka nevojë të kërkohej një gjysmë rimorkio speciale për deblokim të kanalizimit dhe zbrastjen e pusetave, sepse kamioni me sistem vakumi dhe pompë presioni kanë përparësi shumë më të madhe në krahasim me një gjysmë-rimorkio Speciale.

Përgjigjja e AK: Duke pas parasysh se gjatë kësaj së kanalizimit të ri në atë aktual, shumicën e rasteve kanalizimet kanë nevojë për pastrim, prandaj OE obligohet që para se të bëjë testimin dhe funksionalizimin të deblokimit të gypit.

Pretendimi: Makinë sharë me shirit horizontal hidraulike për prerjen e celikut në formë këndore. Pretendimi kërkesa për makinerinë e lartcekur është e panevojshme pasi që në asnjë pozicion të paramasës nuk është kërkuar material nga Çeliku në formë këndore.

Përgjigjja e AK: Duke u bazuar në projektin e administratës, konkretisht në purtë e kulmit tek pjesa e sallës mund ta vërtetë se është parapara të ekzekutohet nga kapriat metalike, gjithashtu edhe pozicioni i fasadës strukturale ku konstruksioni mbajtës i fasadës përbëhet nga çeliku AK e sheh të nevojshme përcjelljen e tillë ashtu që preja e elementeve strukturore të fasadës të bëhet sa më saktë.

Pretendimi: Xhip transportues me korpe me 2 dyer me sistemin e transmissioinit për mundësi tërheqje me të gjitha rrotat 4x4. Mjeti duhet të poscdoj atestet Pretendimi i tyre se Pas shqyrtimit të specifikimeve teknike të kërkesave për furnizim dhe mjeteve të punë në kuadër të projektit "Ndërtimi i projektit të integruar të Bulevardit të qytetit Gjilan", kemi vërejtur një kriter teknik i cili është jorelevant dhe joadekuat për këtë projekt. Në veçanti, kërkesa për "Xhip transportues me korpe me 2 dyer, me sistemin e transmissioinit për mundësi tërheqjeje me të gjitha rrotat (4x4) dhe posedimi i atesteve përkatëse" nuk është i nevojshëm fare për këtë projekt, kurkemi parasysh faktin se projekti i Bulevardit të qytetit të Gjilanit zhvillohet në një zonë urbane dhe jo në terrene të vështira (off-road). Mjetet e tilla zakonisht kërkohen për projekte infrastrukturore në zona të largëta, malc apo rrugë të pa përshtatura, ndërsa për këtë projekt, ku bëhet fjalë për ndërtimin e një bulevardi brenda qytetit, një kërkesë e tillë është e paarsyeshme. Në këtë rast shihet qartë se kjo kërkesë është qesharake, pasi makina e kërkuar është makine sporti GFF ROAD e cila nuk ka të bëjë fare me këtë aktivitet të prokurimit i cili është me lokacion në qendër të qytetit. Përndryshe pajisje e kërkuar nuk është në harmoni me natyrën e kërkuar aktiviteti, kërkojmë që kjo kërkesë të largohet në tërësi nga dosja e tenderit, me qëllim të sigurimit që kriteret e vendosura të jenë të bazuara në nevojat reale të projektit dhe të mos krijojnë kufizime të panevojshme për konkurrencën e operatorëve ekonomikë. Edhe kjo kërkesë sikurse kërkesat e lartcekura favorizojnë OE të caktuar dhe i e tillë duhet të largohet në tërësi nga dosja e tenderit.

Përgjigjia e AK: Pasi do të zhvillohen në qendër mirëpo gropa ndërtimore e cila do të krijohet për ndërtimin e nënkallimit dhe garazhave do të jetë në thellësi të konsiderueshme duke krijuar terren të vështirësuar dhe vështirësi për lëvizje dhe manovrim sidomos gjatë dislokimit të kabllave siq janë ato të kështit dhe instalimeve tjera.

Pretendimi për makinerit me regjistrim valid nga OE-të ankues:

Gjysem Rimorkio kompresor min 1.5T;

Dumper me goma vetshkarkues min 5T;

Luge ngarkues me fshesë;

Luge ngarkues me pirun dhe fshesë

Pretendimi: po ashtu dëshirojmë të shprehim shqetësimin tonë lidhur me kërkesën e vazhdueshme të AK-së për regjistrimin e mjeteve të punës, të cilat përdoren brenda hapësirave të punishtës dhe që në rrethana normale, nuk është e domosdoshme të kenë regjistrim valid. Në këtë rast e kemi fjalën për kërkesat si në vijim

Sa për la sqaruar kërkesën tonë për mjetet e lartcekura që të mos regjistrohen, ju informojmë se mjetet e lartcekura përdoren ekskluzivisht brenda punishtës dhe të njëjti nuk përbëjnë rrezik për pjesëmarrësit në trafik, pasi zona është e kufizuar dhe e ndaluar për qarkullimin e mjeteve të tjera

Përgjigjia e AK: Pasi që punimet jo të ekzekutohen në qendër të qytetit, herë pas herë ato detyrimisht duhet të leviz në afërsi të punishtës jasht saj, ku zhvillohen lëvizjet e qytetarëve dhe automjeteve të tjera. Lëvizja e tyre pa regjistrim do të jetë në kundërshtim me ligjin për trafik, prandaj AK e sheh të arsyeshme të kërkohen.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 08.04.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0237, dhe ankesën me nr.2025/0238 ndërsa me datë 08.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0237 me datën 30.04.2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Si dhe me datën 30.04.2025 eksperti ka dorëzuar raportin e ekspertizës me nr.2025/0238 me rekomandimin si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës me nr.2025/0237 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, “Autoriteti kontraktues nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues. Ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.2025/0238 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, “Autoriteti kontraktues pajtohet Sa i përket pikës ankimore 2 dhe 3 nuk pajtoheni ne si AK - Autoritet Kontraktues rreth raportit të ekspertit shqyrtues. Ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale

Lidhur me pretendimet e OE “SEMAKS” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0237 ka vlerësuar si në vijim: Aktiviteti i prokurimit me titull: “Ndërtimi I projektit të integruar të Bulevardit të qytetit Gjilan” me nr. të prokurimit: "651-25-644-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është parashtruar në fazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Rrjedhimisht, duke qenë se Operatori Ekonomik ankues është i pakënaqur me refuzimin e kërkesës i njëjti parashtron ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues gjatë përpilimit të kërkesave në dosje të tenderit ka shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht nenet: 1,7,44,45,69.

Pretendimi i OE ankues:

OE ankues pretendon se kërkesat mbi aftësitë teknike dhe profesionale lista e projekteve të përfunduara janë diskriminuese, andaj kërkoj të hiqet pjesa e punëve të nënkalimeve.

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në dosje të tenderit të korrigjuar me datë 26/03/2025 ka përcaktuar si më poshtë:

Kërkesa 1. Operatori ose grupi i OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të ndërtimit të natyrës së ngjashme në vlerë prej 15.000,000.00 euro, ndërsa prej tyre 6,000,000.00 euro duhet të jenë punë në projekte të ndërtimit të nënkalimeve. Në rast të grupit, lideri duhet të ketë së paku 2 referenca në ndërtimin e projekteve të nënkalimeve.

Dëshmia 1. Një listë e kontratave të nënshkruar dhe vëlosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata: titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pranimin teknik kopje për kontratat e prezentuara, Nëse kontrata me reference është me kompani private të dëshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është përfunduar pagesa). Referencat apo pranime teknike duhet të jenë në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Rrjedhimisht, bazuar në Rregulloren për Prokurim Publik nr. 001/2022 nën 26.10 definon se AK

26.10 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-së, ku AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga lideri i grupit të OE.

Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 69 par.1 të Ligjit për Prokurim Publik gjithashtu Rregulloren për Prokurim Publik nr. 001/2022 nën 25 par. 13:

Citat:“Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që Operatori Ekonomik të dëshmojë që në përputhje me nenin 69 të LPP-së, në të kaluarën ka përfunduar kontratë të një natyre të ngjashme me një vlerë të caktuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, e cila nuk mund të caktohet më shumë se 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës. Kjo nënkupton se Operatori Ekonomik duhet RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar 52 të plotësojë kërkesën për qarkullim specifik nëse ka përfunduar një apo disa kontrata të një natyre të ngjashme që vetëm ose së bashku arrijnë totalin e vlerës së specifikuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe nuk kërkohet që kjo kërkesë në vlerën e përcaktuar prej 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës të plotësohet vetëm me një kontratë të vetme të asaj vlerë.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK sa i përket vlerës minimale 15,000,000.00 euro karshi vlerës së parashikuar, nuk e tejkalon 1.5 herë, dhe në rastin konkret, marrë parasysh natyrën e projektit dhe punëve të cilat do të realizohen gjithashtu edhe për pjesën e nënkalimit, atëherë në mënyrë që kontrata dhe projekti të realizohet me sukses kërkohet përvoja e operatorit ekonomik gjegjësisht Liderit, i cili përfaqëson grupin dhe gjithashtu siguron se Lideri të përmbushë pjesën e kërkesave me qëllim që të përmbushet realizimi i kontratës. Andaj AK ka përpiluar kërkesën në harmoni me nenin 25.13 dhe 26.10 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.



Pretendimi i dytë i OE ankues:

Kriteri 9.1 dhe 9.2 kërkesa nr.5 një a)OE duhet te ofroj certifikaten e qendrueshmerise se performances dhe konformitetit (EN 40-5 2002-1608-CPR-P033 valide) duke bashkangjitur Certifikaten e karakteristikave te produkteve 6.8m, 12.8m per shtylla konike ndriqimi

b) OE duhet te ofroj certifikaten per kontaktore me standardin IEC 60947-4 2009 dhe nderpreres per orman me standardin IEC 60947-3 2020.

Deshmia 5. a)Certifikata duhet te jete ne emer te OE-se, autorizim ose marreveshje me ndonje kompani e cila posedon autorizimin per kete certifikate. Certifikata duhet te jete me validitet.

b) Certifikata duhet te jete ne emer te OE ose duhet te kete autorizim nga ndonje kompani e cila eshte distributor per shitjen e ketyre produkteve. Certifikata duhet te jete me validitet

Kjo kërkesë është diskriminuese sepse këto certifikata i ofrojnë kompanitë që prodhojnë këto materiale dhe të gjitha materialet që përdoren do të jenë sipas kërkesave të projektit dhe të miratuara nga menaxheri i projektit. Nuk duhet kërkuar standarde nga ofertuesit, pasi që ky tender ka të bëjë më ndërtim e jo me shtylla materiale elektrike, prandaj në këtë rast çdo herë ndodhe bashkëpunimi me kompanitë e specializuara në fushat përkatëse, e të cilat i mbajnë përgjegjësitë për fudnizimet apo shërbimet të cilat i ofrojnë ato. Kërkojmë që të largohet kjo kërkesë nga dosja e tenderit.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

Eksperti teknik vlerëson se certifikatat e kërkuara janë specifike për prodhues të shtyllave të ndriçimit dhe materialeve elektrike siç janë cekur në kërkesë. Vlen të theksohet se tek punët ndërtimore të elektrikes, të gjitha materialet duhet të përmbajnë certifikimet në pajtim me legjislacionin në fuqi, normave dhe standardeve relevante për natyrën dhe fushëveprimin e punëve dhe te materialeve te caktuara.

Kërkesat e përshkruara i përkasin specifikimeve teknike për materialet sipas kërkesës, gjatë realizimit të punëve ndërtimore të elektrikes duhet të kenë kontroll të cilësisë së materialeve të mbështetura me certifikatat përkatëse dhe në mënyrë të vazhdueshme duhet të verifikohen gjatë procesit të menaxhimit të projektit. Duke marrë parasysh faktin se certifikimet/standartet e kërkuara janë për produktet ndërtimore, këto duhet të vërtetohen gjatë fazës së implementimit në pajtim me përshkrimin dhe projektin kryesor, kërkesat e tilla në këtë fazë janë jo relevante, vetëm se kufizojnë konkurrencën duke ndikuar drejtpërdrejt në procedurën e prokurimit. AK duhet të korrigjojë kërkesën pasi që certifikatat e kërkuara janë të panevojshme në këtë fazë.

Eksperti teknik konsideron se pretendimi ankimor 2 është i bazuar.

Pretendimi i tretë i OE ankues:

OE ankues pretendon se kërkesa për pajisje është diskriminuese duke kontestuar pajisjen e Aneks 7 me numrat: 8;16;17;18;19;26;27;28;30;31;32;33;34;35, për arsye se, këto pajisje/makineri të kërkuara nuk kanë lidhmëri me natyrën dhe qëllimin e projektit dhe pozicioneve në paramasë, andaj kërkojmë nga AK që këto kërkesa të korrigjohen dhe një pjesë të largohen krejt sepse janë të panevojshme dhe e shpien drejtë favorizimit të një kompanie të caktuar dhe mundësi së keqpërdorimit të buxhetit. Janë kërkuar disa pajisje sikur të jetë tender

për elektrikë, e disa pajisje janë kërkuar që nuk kanë fare të bëjnë me ndonjë pozicion, prandaj këto duhet të ndryshohen me qëllim që të ketë konkurrencë të hapur.

### Përgjigje në pretendimin ankimor 3

Eksperti teknik e ka analizuar të gjithë listën e pajisjeve dhe konstaton se në dosjen e tenderit janë kërkuar gjithsejtë 35 lloje të pajisjeve dhe makinerive me të cilat do të realizohet projekti.

Eksperti sqaron se çdo projekt që hartohet për ekzekutim përmban metodologjinë e punës, ku ndër të tjera përcaktohen afatet kohore dhe resurset e projekti. Konform organizimit dhe teknologjisë së ndërtimit, metodologjisë së punës dhe afateve kohore përcaktohen edhe angazhimet e stafit të nevojshëm dhe makinerisë së domosdoshme për realizimin e aktiviteteve të punëve ndërtimore dhe projektit. Bazuar në këto analiza vlerësohen edhe pajisjet dhe makineritë minimale të domosdoshme për realizimin e projektit. Duke u bazuar edhe në përgjigjet e AK në kërkesën për rishqyrtim nuk mund të theksohet se ekzistojnë këto plane dhe dokumente të projektit, andaj eksperti teknik do të vlerësoj duke u bazuar në fushëveprimin e projektit dhe përshkrimit të pajisjeve të kërkuara.

Disa nga pajisjet e kërkuara janë subjekt i pikës ankimore nga OE dhe në vazhdim do të përshkruhet vlerësimi i tyre sipas numrit rendor të pajisjes në listën e bashkëngjitur nga AK –Aneksi 7

### Pajisja nr. 8

Gjysemrimorkio speciale me 2 pompa për debllokimin e kanalizimit dhe zbrasjen e pushtave me presion min. 200 bar me kapacitet 5000 litra.

OE ankues kërkon që kjo pajisje të largohet nga DT pasi që në asnjë pozicion të projektit nuk përfshihet pajisja në fjalë

### Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti vlerëson se në baze të përshkrimit të punëve kjo lloj pajisje nuk gjen përdorim në projektin në fjalë dhe është e panevojshme. Nëse AK ka vlerësuar se kjo pajisje është e nevojshme duhet të ketë edhe pozicionet e punëve ndërtimore të cilat ndërlidhen me shfrytëzimin e pajisjes. Në përgjigjen e dhënë nga AK është vlerësuar se pajisja në fjalë shërben për debllokimin e gypave në kucje të rrjetit të ri të kanalizimit, gjë që ky pozicion mungon në paramasë dhe nuk ka se si të realizohet. AK duhet të korrigjoj dosjen e tenderit pasi që pajisja është e panevojshme

pretendimi për pajisjen nr.8 konsiderohet i bazuar.

### Pajisja nr. 16 Vinq hidraulik i destinuar për ngarkimin dhe shkarkimin e automjeteve

OE ka kërkuar që kjo pajisje të largohet nga kërkesa pasi që ka mënyra tjera të ngarkim dhe shkarkim të automjeteve.

AK në përgjigjen e dhënë ka deklaruar se është menduar për ngarkim dhe shkarkim të materialeve ndërtimore. Dhe mjafton që të jetë një vinq hidraulik për ngarkim dhe shkarkim, AK do të pranojë këtë kërkesë. Përgjigje nga eksperti teknik. Eksperti teknik vlerëson se kërkesa për pajisjen në fjalë është diskriminuese pasi që ka metoda dhe mënyra të ndryshme për ngarkimin

dhe shkarkimin e automjeteve. Kjo pajisje është mjaft e rrallë në zbatim dhe një kërkesë e tillë vetëm se kufizon konkurrencën dhe orienton për OE të caktuar. Duke u bazuar në përgjigjen e dhënë nga AK, eksperti teknik konsideron se përshkrimi i pajisjes duhet të modifikohet në kërkesën e dosjes së tenderit dhe të përshtatet me natyrën e punës për të cilën AK ka menduar që është e nevojshme.

AK të modifikoj kërkesën sipas përshkrimit të dhënë në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim, ose të largoj pajisjen në fjale nga DT.

Pretendimi për pajisjen nr.16 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 17

Vinç -ashensor me konstruksion metalik për bartjen dhe ngritjen e materialeve elektromotor, me trupa të ashensorit deri në 40m

OE ka kërkuar që pajisja të largohet nga DT si e panevojshme pasi që tek sheshet nuk ka pozicion për këtë lartësi 40m dhe nuk arrihet nga objektet që do të ndërtohen.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se përshkrimi për pajisjen nr. 17 është kufizues dhe po ashtu lartësia deri 40 metra përkufizon një pajisje mjaft specifike. Meqenëse janë pajisje mjaft të rralla, përshkrimi i tillë është kufizues, andaj AK duhet të ofroj mundësinë edhe për pajisje tjera që kryejnë shërbimet e njëjta dhe mos të kufizohet vetëm tek ky lloj i pajisjes.

Eksperti teknik vlerëson se ka makineri të ndryshme që kryejnë funksionin e njëjtë për ngritjen e materialeve në nivelet e objektit gjatë ndërtimit, siç janë vinç kullat, andaj kërkesa duhet të korrigjohet, të modifikohet dhe të krijohen mundësitë edhe për përdorimin e makinerive tjera standarde për këtë lloj pune.

Pretendimi i OE ankues se pajisja nuk mund të përdoret nuk qëndron pasi që në kuadër të projektit është parapare të ndërtohet objekti i administratës që ka një lartësi të caktuar, andaj përshkrimi i lartësisë për pajisjen deri në 40 m është vendosur si prag maksimal dhe lejon tolerancën për të ofruar pajisje që operojnë me lartësi më të vogël se pragu maksimal.

AK të bëjë korrigjimin e kërkesës, të vlerësoj në bazë të analizës së projektit dhe të krijoj mundësinë e përdorimit edhe të pajisjeve tjera pa e kufizuar konkurrencën.

Pretendimi për pajisjen nr.17 konsiderohet pjesërisht i bazuar.

Pajisja nr. 18

Instrument për certifikim dhe testim të kabllave (Multimates TESTPRO CV100-K50 COPPER CERTIFICATION KIT)

OE ka kërkuar që pajisja të largohet si e panevojshme pasi që këto janë instrumente të kompanive të specializuara në këtë fushë dhe se OE mund të kontraktojnë këto kompani për këto shërbime. OE ka sqaruar se këtu kemi të bëjmë me ndërtim dhe normalisht që këtu ofertojnë kompanitë e ndërtimit dhe ato nuk mund t'i posedojnë edhe instrumentet për certifikim dhe testim të kabllave.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se në kuadër të projektit ekzistojnë punët ndërtimore të elektrikes për të cilat gjatë realizimit të tyre mund të nevojitet testime të shpejta që realizohen nga pajisje profesionale për testimin dhe certifikimin e kablllove të rrjetit. Instrumenti shërben për të realizuar testimet e nevojshme të kablllove dhe për të siguruar performance dhe cilësi me të mire gjatë realizimit të projektit.

Pretendimi për pajisjen nr.18 konsiderohet i pa bazuar.

Pajisja nr. 19

Makine sharre me shirit horizontal hidraulike për prerjen e celikut në formë këndore

OE e ka konsideruar si të panevojshme këtë lloj pajisje pasi që nuk ka pozicione në parametere ku pajisja gjë përdorimin e saj.

Përgjigje nga eksperti teknik

AK në përshkrimin e pajisjeve ka dhënë specifika për pajisje shumë detale, shumica e përshkrimeve determinojnë procesin e punës me të cilin OE-të mund të kryejnë edhe me pajisje tjera që kanë funksion të njëjtë. Mbivlerësimi i kërkesave dhe numri i madh i pajisjeve të cilat i ka përshkruar AK kufizon konkurrencën. Eksperti teknik vlerëson se kjo pajisje varësisht prej procesit të punës të cilin e zhvillon OE mund të jetë e panevojshme, pasi që këtë lloj pune e kryen në formë të tjera, ku me zhvillimin e teknologjisë ka edhe formë më të avancuar.

AK të bëjë korrigjimin e kërkesës së DT dhe të largoj pajisjen nga kërkesat e DT.

Pretendimi për pajisjen nr.19 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 26. Automikser vetngarkues për prodhimin e betonit

OE ankues ka kërkuar që të largohet kërkesa për librezë qarkullimi për pajisjen në fjalë meqenëse kjo makineri mund të jetë pa regjistrim sepse përdoret vetëm brenda punishtës.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se sipas ligjit për automjete specifikohet që mjetet motorike rrugore të dedikuara për përdorim në kantiere ndërtimi, janë të përjashtuara nga homologimi dhe nuk ka nevojë të regjistrohen për qarkullim rrugor. Meqenëse kjo pajisje nuk merr pjesë në trafikun rrugor dhe se operimi i saj është në vend ndërtim ajo mund të bartet me pajisje transportuese për makineri dhe nuk ka nevojë për librezë qarkullimi.

Kërkesa për të pasur librezë qarkullimi për këtë pajisje duhet të largohet.

Pretendimi për pajisjen nr.26 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 27. Kamion kiper me kran gjatësia e kranit min 20m, Mjeti duhet të posedoj pëlqim ose atest

OE nuk është pajtuar me kërkesën që AK ka kërkuar pëlqim ose Atest duke e konsideruar si favorizim për OE të caktuar.

## Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se përshkrimi i kërkesës që pajisja duhet të posedoj pëlqim ose atest është i paqartë pasi që nuk dihet çfarë lloj pëlqimi apo atesti bëhet fjale, ky përshkrim është kufizues, diskriminues e i panevojshëm dhe duhet të largohet nga kërkesa e DT. Eksperti sqaron se makineria e cila i nënshtrohet kontrollit të rregullt teknik nuk ka nevojë për pëlqim ose atest.

Pëlqim ose Atest përmes të cilit vërtetohet funksioni në gjendje të rregullt i pajisjes, mund të kërkohej për pajisje të cilat nuk i nënshtrohen kontrollit dhe regjistrimit të rregullt.

AK të korrigjoj kërkesën e DT, modifikoj dhe të largoj nga kërkesa përshkrimin “pëlqim ose atest”.

Pretendimi për pajisjen nr.27 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 28 Gjysem Rimorkio kompresor min 1.5T

OE nuk është pajtuar për kërkesën që pajisja të ketë regjistrim valid pasi që kjo pajisje përdoret vetëm brenda në punishte dhe nuk ka nevojë për regjistrim.

Përgjigje nga eksperti teknik. Eksperti teknik konsideron se kërkesa për automjetet që të kenë librezë qarkullimi valide duhet të jete në përputhje me legjislacionin specifik. Pajisjet të cilat operimin e kanë vetëm në vend punishte nuk kanë nevojë të regjistrohen.

AK të korrigjoj kërkesën dhe të largoj kriterin për librezën e qarkullimit për pajisjen përkatëse.

Pretendimi për pajisjen nr.28 konsiderohet i bazuar. Pajisja nr. 30 Traktor me fshise për pastrim. Max 1.5T. OE e ka konsideruar si të panevojshme pajisjen, pasi që kjo me shume ka të bëjë me mirëmbajtje dhe pastrim.

Përgjigje nga eksperti teknik. Eksperti vlerëson se OE ka dhënë argumentet që kjo pajisje është e pa nevojshme, pasi që këto janë punë ndërtimore e jo mirëmbajtje të hapësirave publike. Pajisja nuk është relevante me natyrën e punëve ndërtimore dhe nuk duhet të jete kriter i kërkesës në fjalë, si e tillë duhet të largohet nga DT.

Pretendimi për pajisjen nr.30 konsiderohet i bazuar. Pajisja nr. 31. Xhip transportues me korpe me 2 dyer me sistemin e transmisionit për mundësi tërheqje me të gjitha rrotat 4x4. Mjeti duhet të posedoj atestat. OE ka cilësuar se pajisja e kërkuar nuk ka lidhje me asnjë pozicion në paramasë dhe ka kërkuar të largohet kjo kërkesë. Përgjigje nga eksperti teknik. Eksperti vlerëson se pajisja në fjalë nuk ndërlidhet me asnjë aktivitet të punës, është kërkesë e tepërt, diskriminuese dhe jep mundësinë e kufizimit të konkurrencës duke e orientuar konkurrencën tek operator ekonomik të caktuar. Automjeti i kërkuar nuk ndërlidhet me punët ndërtimore të natyrës së projektit.

AK të korrigjoj DT dhe pajisjen në fjalë të largoj nga dosja e tenderit. Pretendimi për pajisjen nr.31 konsiderohet i bazuar. Pajisja nr. 32 Furgon special për punime elektrike me 2 dyer

OE kërkon që kërkesa të ndryshohet pasi që për punimet elektrike ka edhe mënyra tjera të punës dhe nuk do të thotë se është e domosdoshme të posedohet makineri speciale. Përgjigje nga eksperti teknik Eksperti vlerëson se punimet elektrike mund të realizohen në metoda tjera pa pasur nevojë për automjetin në fjalë kështu që pajisja e kërkuar është e panevojshme dhe nuk duhet të jetë kriter i DT. AK të korrigjoj kërkesën e DT pasi që pajisja është e panevojshme.

Pretendimi për pajisjen nr.32 konsiderohet i bazuar.

Pajisja nr. 33 Dumper me goma vetshkarkues min 5T. OE ankues ka kërkuar që kjo makineri meqenëse ka përdorim vetëm në vend ndërtim mund të jetë pa regjistrim dhe mund të jetë me kapacitet më të vogël se 5T. Përgjigje nga eksperti teknik. Eksperti vlerëson se sipas ligjit për automjete, makineria që operon në vend ndërtim nuk ka nevojë të regjistrohet, ajo mund të transportohet deri në vend punishte me makineri transportuese.

Sa i përket kapaciteti të tonazhës, eksperti konsideron se AK ka vendosur kufirin minimal të kapacitetit të pajisjes që është min. 5t, me këtë prag AK ka dhënë hapësirë për tolerancën me të cilën ofertuesit mund të ofertojnë me kapacitet më të mëdha se 5t, po ashtu është përgjegjësi e AK të vlerësoj kapacitetin që nevojitet në harmoni me kërkesat e projektit.

AK të bëjë korrigjimin e kërkesës në DT të largoj kërkesën për librezën e qarkullimit për makinerinë përkatëse. Pretendimi për pajisjen nr.33 konsiderohet pjesërisht i bazuar. Pajisja nr. 34 dhe 35. Luge ngarkuese me fshesa. Luge ngarkuese me pirun dhe fshesa

OE ankues ka kërkuar që këto pajisje të largohen pasi që janë të panevojshme për natyrën e punës.

Përgjigje nga eksperti teknik

Eksperti teknik vlerëson se në bazë të fushëveprimit të projektit këto pajisje nuk ndërlidhen aspak me natyrën e punëve ndërtimore dhe si të tilla duhet të largohen nga dosja e tenderit. AK duhet të vendosë kërkesat që ndërlidhen me punët ndërtimore dhe realizimin e projektit. Arsyetimi i AK në përgjigje nuk qëndron pasi që sipas legjislacionit në fuqi vend ndërtimi duhet të kufizohet dhe të mirëmbahet në mënyrë që hapësirat jashtë vend ndërtimit të mos ndikohen nga realizimi i projektit në fjalë. Pretendimi për pajisjen nr.34 dhe 35 konsiderohet i bazuar. Pretendimi i katërt i OE ankues: Kuvendi Komunal Gjilan ka publikuar tenderin në fjalë me datë 18/03/2025, ku sipas dosjes së tenderit afati i fundit për dorëzimin e tenderëve është data 07/04/2025. Me rastin e përcaktimit të afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 44 dhe 45 të LPP-së. Sipas dispozitave të nenit 44 të LPP-së, në rast të kontratave me vlerë të madhe, AK duhet që të mbajë tenderin të hapur në një afat jo më pak se 40 ditë. Ndërsa në rastet kur ka njoftim paraprak, atëherë tenderi duhet të jetë i hapur jo më i shkurtër se 24 ditë. Andaj AK nuk ka pas parasysh faktin se afatet për ofertim të janë në harmoni me natyrën dhe qëllimin e projektit gjithnjë duke pasur parasysh kërkesat e shumta që duhet të plotësohen për të përgatitur një ofertë serioze.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se, lidhur me afatin ligjor për dorëzim të tenderëve, AK në Dosje të tenderit ka specifikuar gjithashtu arsyen e përshpejtimit dhe shkurtimit të afatit për dorëzim të tenderëve, e cila bazuar në E-prokurim i bie 22 ditë nga data e njoftimit për kontratë deri në ditën e dorëzimit të tenderëve, dhe si e tillë bazuar në nenin 46 të Ligjit për Prokurim Publik – 46-Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore, paragrafi 2 citat:

2. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që përdor procedurat e hapura të prokurimit, autoriteti kontraktues mund të përcaktojë një afat të caktuar kohor për pranimin e tenderëve që është:

2.1. nëse kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë; ose

2.2. nëse kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dhjetë (10) ditë.

Dhe rrjedhimisht AK ka vepruar sipas nenit 46 të LPP-së duke shkurtuar afatin nga 40 ditë në 22 ditë, dhe në rastin konkret ky pretendim ankimor është irelevant për shkak të zgjatjes së afatit të procedurave ankimore.

Si përfundim, bazuar në sqarimet e dhëna, rekomandohet që AK të bëjë ndryshimet në dosje të tenderit dhe të bëhet zgjatja e afatit për dorëzim.

Shënim: Për këtë aktivitet të prokurimit gjendet edhe ankesa me nr.238/25 dhe raporti i dorëzuar.

Lidhur me pretendimet e OE “Pro & Co Group” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0238 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Ndertimi I projektit të integruar të Bulevardit të qytetit Gjilan” me nr. të prokurimit: "651-25-644-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm

Ankesa është parashtruar në fazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Rrjedhimisht, duke qenë se Operatori Ekonomik ankues është i pakënaqur me refuzimin e kërkesës i njëjti parashtron ankësë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues gjatë përpilimit të kërkesave në dosje të tenderit ka shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht nenet: 1,7,10,28,51,69.

Pretendimi i OE ankues:OE ankues pretendon se kërkesa në dosje të tenderit 9.1&9.2 lidhur me projektet e përfunduara është diskriminuese dhe kërkojnë të behën ndryshime në këtë formë:

Operatori Ekonomik ose grupi i OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të ndërtimit të natyrës së ngjashme në vlerë 15,000,000.00 euro.

Ose

Operatori Ekonomik ose grupi i OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të ndërtimit të natyrës së ngjashme në vlerë 15,000,000.00 euro, ndërsa prej tyre 6,000,000.00 euro duhet të jenë punë në projekte të ndërtimit të nënkalimeve. Në rast të grupit, njëri nga anëtarët e grupit duhet të ketë së paku 2 referenca në ndërtimin e projekteve të nënkalimeve.

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në dosje të tenderit të korrigjuar me datë 26/03/2025 ka përcaktuar si mëposhtë:

Kërkesa 1. Operatori ose grupi i OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të ndërtimit të natyrës së ngjashme në vlerë prej 15.000,000.00 euro, ndërsa prej tyre

6,000,000.00euro duhet te jene pune ne projekte te ndertimit te nenkalimeve. Ne rast te grupit, lideri duhet te kete se paku 2 referenca ne ndertimin e projekteve te nenkalimeve.

Dëshmia 1. Një listë e kontratave e nënshkruar dhe vulosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pranimin teknik kopje për kontratat e prezentuara, Nëse kontrata me reference është me kompani private te deshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është pëfundu pagesa). Referencat apo pranime teknike duhet te jene ne 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Rrjedhimisht, bazuar në Rregulloren për Prokurim Publik nr. 001/2022 neni 26.10 definon se AK

26.10 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se, ku AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga lideri i grupit të OE

Gjithashtu, bazuar edhe në neni 69 par.1 të Ligjit për Prokurim Publik gjithashtu Rregulloren për Prokurim Publik nr. 001/2022 neni 25 par. 13:Citat: “Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që Operatori Ekonomik të dëshmojë që në përputhje me nenin 69 të LPP-së, në të kaluarën ka përfunduar kontrata të një natyre të ngjashme me një vlerë të caktuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, e cila nuk mund të caktohet më shumë se 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës. Kjo nënkupton se Operatori Ekonomik duhet RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar 52 të plotësojë kërkesën për qarkullim specifik nëse ka përfunduar një apo disa kontrata të një natyre të ngjashme që vetëm ose së bashku arrijnë totalin e vlerës së specifikuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe nuk kërkohet që kjo kërkesë në vlerën e përcaktuar prej 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës të plotësohet vetëm me një kontratë të vetme të asaj vlere”

Ekspertja sqaron se, AK sa i përket vlerës minimale 15,000,000.00 euro karshi vlerës së parashikuar, nuk e tejkalon 1.5 herë, dhe në rastin konkret, marrë parasysh natyrën e projektit dhe punëve të cilat do të realizohen për pjesën e nënkalimit, ku kontrata dhe projekti të realizohet me sukses kërkohet përvoja e operatorit ekonomik gjegjësisht Liderit, i cili përfaqëson grupin dhe gjithashtu siguron se Lideri të përmbushë pjesën e kërkesave me qëllim që të përmbushet realizimi i kontratës. Andaj AK ka përpiluar kërkesën në harmoni me nenin 25.13 dhe 26.10 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.

Pretendimi i dytë i OE ankues:

OE ankues pretendon se kërkesa nr.2 tek 9.1&9.2 është diskriminuese: Kriteri 9.1 dhe 9.2 Kërkesa 2. OE duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon: Një bachelor i diplomuar i hidroteknikës i certifikuar në AME për mbrojtje nga zjarri (min 5 vite përvojë pune nga data e certifikimit). Kjo kërkesë është tërësisht e kundërligjshme dhe favorizuese për OE të caktuar (kryesisht të huaj), pasi që këto certifikata në Kosovë, kanë filluar të lëshohen vetëm në dy vitet e fundit, dhe nuk janë lëshuar më herët, andaj është edhe e pamundur që të posedohen me këtë validitet. Po ashtu edhe nëse një bachelor i diplomuar i hidroteknikës, nuk e ka këtë certifikatë, OE është i detyruar që sipas nënit 13 të kontratës, të ofroj siguri në vendëpunishte. Për më tepër, këto detyrime caktohen edhe nga Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë. Andaj, kjo



kërkesë duhet të ndryshohet dhe të hiqet nga kriteret e DT-së. Përgjigje në pretendimin ankimor:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues shpjegon se, AK në DT tek kërkesa nr.2 pika f. ka kërkuar:

f) Nje bachelor i diplomuar i hidroteknikes i certifikuar ne AME per mbrojtje nga zjarri (min 5 vite pervoje pune nga data e certifikimit)

Dëshmia e kërkuar: Per stafin profesional te deshmohen me diplome dhe certificate perkatese sipas kerkeses, kontratat e punes ose marreveshjet mbi angazhim ne emer te projektit dhe validitet me validitet dhe kohezgjatje per kete projekt. Per diplomat e fituara jashte republikes se Kosoves kerkohen qe te jene te Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosoves.

Andaj AK ka kërkuar Bachelor i diplomuar i Hidroteknikës me përvojë minimale 5 vjeçare pas diplomimit, ndërsa sa i përket certifikatës së kërkuar për mbrojtje nga zjarri, rekomandohet AK që ta hap konkurrencën duke mos specifikuar, por të lejohet që të ofrohet nga cilido inxhinier pa e specifikuar përvojën pas certifikimit. Pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i tretë i OE ankues: Kriteri 9.1 dhe 9.2 kërkesa nr.5 një a) OE duhet te ofroj certifikaten e qendrushmerise se performances dhe konformitetit (EN 40-5 2002-1608-CPR-P033 valide) duke bashkangjitur Certifikaten e karakteristikave te produkteve 6.8m, 12.8m per shtylla konike ndriqimit. b) OE duhet te ofroj certifikaten per kontaktore me standardin IEC 60947-4 2009 dhe nderpreres per orman me standardin IEC 60947-3 2020. Dëshmia 5. a) Certifikata duhet te jete ne emer te OE-se, autorizim ose marreveshje me ndonje kompani e cila posedon autorizimin per kete certificate. Certifikata duhet te jete me validitet. b) Certifikata duhet te jete ne emer te OE ose duhet te kete autorizim nga ndonje kompani e cila eshte distributor per shitjen e ketyre produkteve. Certifikata duhet te jete me validitet. Këto certifikata nuk shërbejnë fare për objektin e kontratës, meqë të njëjtat përdoren vetëm në rastet kur tenderët përfshijnë shumicën dërmuese elemente elektrike, si KKEK, KEDS, apo institucione tjera të energjisë. Në rastin konkret, janë plotësisht të panevojshme, meqë të gjitha përfshijnë elemente të punës në energji elektrike dhe jo në punë ndërtimore. Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese sqaron se ky pretendim ankimor është trajtuar edhe në ankesën 237/25 për të cilën bazuar në përgjigjen e dhënë nga eksperti teknik kjo kërkesë duhet të largohet nga dosja e tenderit. S'i përfundim, sipas sqarimeve të dhëna, rekomandohet që AK të bëjë ndryshimet në dosje të tenderit dhe të bëhet zgjatja e afatit për dorëzim.

Shënim: Për këtë aktivitet të prokurimit gjendet edhe ankesa me nr.237/25 dhe raporti i dorëzuar

#### ***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues për ankesën e OE “SEMAKS” SH.P.K., me nr. 2025/0237 dhe ankesën e OE “Pro & Co Group” SH.P.K., me nr. 2025/0238 ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur në tërësi besimin ekspertit shqyrtues sa i përket përgjigjeve në këto pretendime të operatorit ekonomik ankues.

Po ashtu, duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit.

Andaj PSH, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish, do të ndalet në shqyrtim vetëm në pretendimet përcaktuese lidhur me vendimmarrjen në këto lëndë dhe në përgjigjet në pretendimet ankimore të ekspertit shqyrtues të cilave paneli shqyrtues nuk ja ka fal besimin:

*Lidhur me pohimet ankimore të OE SEMAKS SHPK 2025/0237*

Ankuesi ka atakuar kërkesën e AK sa i përket certifikatave; a) OE duhet të ofroj certifikatën e qëndrueshmërisë së performancës dhe konformitetit (EN 40-5 2002-1608-CPR-P033 valide) duke bashkangjitur Certifikatën e karakteristikave të produkteve 6.8m, 12.8m për shtylla konike ndriçimit. b) OE duhet të ofroj certifikatën për kontaktore me standardin IEC 60947-4 2009 dhe ndërprerës për orman me standardin IEC 60947-3 2020. Ngase sipas ankuesit këto certifikata janë diskriminuese. Këtë pretendim të ankuesit eksperti e përkrah, pa ndonjë argument apo provë, por vetëm mbi bazën e supozimeve duke i quajtur si kërkesa irelevante. Paneli Shqyrtues lidhur me këto përgjigje të thata dhe pa ndonjë argument dhe kundërtëhënës nuk mund ta mbështesë ekspertin shqyrtues, ngase në njërin anë thotë janë jo relevante ndërsa në anën tjetër thotë se këto kanë të bëjnë me specifikime teknike dhe duhet të verifikohen gjatë procesit të menaxhimit të projektit.

Ankuesi ka atakuar edhe listën e pajisjeve të kërkuara nga AK, ku eksperti shqyrtues/teknik ka dhënë shumë thjeshtë dhe pa ndonjë element bazë se pse pajisja të cilën e kërkuar AK duhet të largohet, duke deklaruar vetëm se kjo pajisje është shumë e rrallë dhe ngushtën konkurrencën, kjo përgjigje nga ana e një eksperti është mjaftë jo profesionale e pa argumentuar, ngase, nuk mund të largohet një pajisje nga një projekt aq i madh dhe të rrezikoj implementimin e tij vetëm se ndonjë pajisje është e rrallë dhe të detyroj AK të bëjë veprime për të cilat do të kushtoj më vonë dhe mund të rrezikoj implementimin e kontratës. Kështu që, Paneli Shqyrtues këtë pretendim e kualifikon si pjesërisht të bazuar për faktin se AK si iniciues i këtij aktiviteti të prokurimit, konform nenit 27 dhe 69 të LPP të përcaktoj dhe të kërkoj mjetet e punës konform nevojave të cilat i parasheh për atë aktivitet, dhe është përgjegjësi e vetë AK përderisa në Dosje të Tenderit ka lënë mundësi, me marrëveshje me qira. Pavarësisht se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, është i pamjaftueshëm që të anulohet njoftimin për kontratë.

Po ashtu, lidhur me këtë, Paneli, shpjegon po ashtu se Autoriteti Kontraktues (AK), në kuptim të nenit 1, 6 dhe 7 dhe në përputhje me nenin 115 të Ligjit për Prokurim Publik, nga cilësia e saj si iniciuese e këtij aktiviteti të prokurimit, kishte mundësinë të rishikonte sërish kërkesat e DT, bazuar në gjetjet e ekspertit shqyrtues. Ku, Ligji specifikon se nëse AK vërteton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme dhe nuk janë refuzuar nga ankuesi, ata mund të ndërmarrin veprime korrigjuese të rekomanduara nga eksperti. Megjithatë, edhe në këtë rast, AK ka vazhduar të refuzojë raportin e ekspertit.

Si rrjedhoj, Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit, ka vendosur që ankuesen e ankuesit ta kualifikoj si pjesërisht të bazuar por e pamjaftueshme që të anuloj njoftimin për kontrat, andaj PSH vendos që të lë në fuqi njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i projektit të integruar të Bulevardit të qytetit Gjilan” me nr.prokurimi: 651-25-644-5-1-1, dhe AK të vazhdoj tutje me aktivitetin e prokurimit.

*Lidhur me pohimet ankimore të OE “Pro & Co Group” SH.P. K 2025/0238*

Ankuesi në këtë rast ka atakuar kërkesën e vendosur lidhur me kontrata dhe projekte të natyrës së ngjashme në vlerë prej 15.000,000.00 euro, prej tyre për punë në projekte të ndërtimit të nënkalimeve 6,000,000.00euro, PSH konsideron se kjo kërkesë është trajtuar në mënyrë profesionale nga eksperti shqyrtues në raportin e tij duke e argumentuar saktësisht se këkesa e vendosur nga AK sa i përket vlerës minimale 15,000,000.00 euro karshi vlerës së parashikuar, nuk e tejkalon 1.5 herë, dhe në rastin konkret, marrë parasysh natyrën e projektit dhe punëve të cilat do të realizohen për pjesën e nënkalimit, ku kontrata dhe projekti të realizohet me sukses kërkohet përvoja e operatorit ekonomik gjegjësisht Liderit, i cili përfaqëson grupin dhe gjithashtu siguron se Lideri të përmbushë pjesën e kërkesave me qëllim që të përmbushet realizimi i kontratës. Andaj PSH se AK ka përpiluar kërkesën në harmoni me nenin 25.13 dhe 26.10 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022.

Ankuesi në këtë rast ka atakuar kërkesën e vendosur nga AK lidhur me f) Nje bachelor i diplomuar i hidroteknikes i certifikuar ne AME per mbrojtje nga zjarri (min 5 vite pervoje pune nga data e certifikimit). Paneli Shqyrtues konsideron se kjo kërkesë nuk është diskriminuese ngase si e tillë dhe në konsistencë edhe me vendimet paraprake të OSHP është relevante me natyrën e këtij projekti konform nenit 51 të LPP, ngase sipas natyrës së këtij projekti AK e ka parë të nevojshme se kjo kërkesë është e domosdoshme si e tillë dhe PSH nuk mund ta detyroj AK që të variojë me kërkesa vetëm se një inxhinieri i një OE nuk mund ta ketë këtë certifikate, ngase AK në këtë rast ka lejuar tolerancë që ky inxhinier mund të ofrohet edhe me parakontratë pa pasur nevojë që inxhinieri domosdoshmërisht të jetë i punësuar tek një OE i caktuar në këtë rast i ankuesit.

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e produkteve që plotësojnë nevojat adekuate të tyre, si dhe pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në këtë aktivitet.

Lidhur me pretendimin sa i përket certifikatave PSH ka dhënë përgjigje dhe e ka shqyrtuar tek ankesa me nr. 2025/0237.

Si rrjedhoj, Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit, ka vendosur që ankuesen e ankuesit ta kualifikoj si pjesërisht të bazuar por e pamjaftueshme që të anuloj njoftimin për kontrat, andaj PSH vendos që të lë në fuqi njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i projektit të

integruar të Bulevardit të qytetit Gjilan” me nr.prokurimi: 651-25-644-5-1-1, dhe AK të vazhdoj tutje me aktivitetin e prokurimit.

### ***Përfundim***

Për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj, ku në këtë procedur vërehet që AK-ja ka bërë edhe korigjimin e procedurës (26.03.2025) . Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Po ashtu vlen të përsëritet sërish fakti se në rastet kur një operator ekonomik i caktuar nuk i përmbushë kërkesat e dosjes së tenderit, i njëjti mund të bashkohet në formë të grupit të operatorëve ekonomik çofshin OE vendor apo edhe ndërkombëtar . Përndryshe fakti që një ose disa operator ekonomik nuk i përmbushin kërkesat e DT, nuk nënkupton që kërkesat janë hartuar gabimisht. Sidoqoftë, pa pasur nevojë që të përsëriten kërkesat e DT për të cilat janë parashtruar pretendimet ankimore, në rastin konkret dhe sipas bindjes së këtij Paneli Shqyrtues të gjithë kërkesat e dosjes së tenderit janë hartuar me kujdes nga AK. Absolutisht secila kërkesë mund të jetë e domosdoshme për realizimin me sukses të projektit dhe mospërmbushja e cilësdo kërkesë mund të rrezikoj dukshëm realizimin efikas dhe efektiv të projektit, e sidomos një projekt me rëndësi dhe vlerë të madhe. Nga sa u tha më sipër është gjetur se ankuesit nuk kanë paraqitur argumente të qëndrueshme për të anuluar njoftimin për kontratë të AK.

Andaj, AK është përgjegjëse edhe për hartim të DT, sipas nenit 27 dhe 28 të LPP. 18 Paneli Shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të pjesërisht të ankesave të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP. Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - Pro & Co Group SH.P.K., SEMAKS SH.P.K., SEMAKS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: